



BASHKIA
TIRANË

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 81, datë 26.07.2017

PËR

**“MIRATIMIN NË PARIM TË STUDIMIT TË FIZIBILITETIT DHE TË KONTRATËS
“TIP” TË PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT “PËR PËRMIRËSIMIN E
INFRASTRUKTURËS ARSIMORE NË BASHKINË TIRANË”, NDËRMJET BASHKISË
TIRANË DHE PARTNERIT PRIVAT”.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat (a) dhe (b), nenit 33, pika 1, shkronja (ç), nenit 54, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, vendimit nr.353, datë 19.04.2017 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e autoriteteve kontraktore për të ndërmarrë e zhvilluar procedurat për dhënien me koncension/partneritet publik privat, të projektit me objekt “Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë e Tiranës”, si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin në parim të studimit të Fizibilitetit “Përmirësimi i Infrastrukturave Arsimore në Bashkinë e Tiranës” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e kontratës “Tip”, të partneritetit publik privat “Për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Bashkinë e Tiranës”, ndërmjet Bashkisë në cilësinë e autoritetit kontraktues dhe partnerit privat, i cili do të rezultojë fitues pas përfundimit të këtij procesi të konkurimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë, në rolin e autoritetit kontraktues për negocimin e kësaj kontrate “Tip” me partnerin privat fitues, pa ndryshuar kushtet e përgjithshme të kontratës “Tip”.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë dhe Komisioni i Koncesionit i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI